



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 03. 09. 2019, ora 10.30

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11226, datë 15. 7. 2019 “Për kthimin e ligjit nr. 37/2019 “Për disa shtesa në aktin normativ, me fuqinë e ligjit nr. 4, datë 9. 7. 2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24. 7. 2008 dhe ndryshuar me ligjin nr. 3/2015”.

2. Shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11251, datë 5. 8. 2019 “Për kthimin e ligjit nr. 50/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar””.

3. Shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11254, datë 8. 8. 2019, “Për kthimin e ligjit nr. 51/2019 “Për miratimin e kontratës së koncesionit/PPP ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si autoriteti kontraktor, dhe “Gjiguria”, sh.p.k., si koncesionari, dhe shoqërisë koncesionare “Rruga Orikum - Llogara”, sh.p.k., për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugës “Porti i Jahteve - bypass Orikum - Dukat (ura e Shën Elizës)””.

4. Shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11255, datë 8. 8.2019, “Për kthimin e ligjit nr. 52/2019 “Për miratimin e kontratës së koncesionit/PPP ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si autoriteti kontraktor, shoqërisë “ANK”, sh.p.k., si koncesionari, dhe shoqërisë “Bardh konstruksion”, sh.p.k., si shoqëria koncesionare, për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor Milot – Balldren””.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Evis Kushi, Senida Mesi, Blerina Gjylameti, Krenar Rryçi, Ervin Bushati, Reme Lala, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Suzana Topi, Korab Lita, Ardit Konomi, Sadi Vorpsi, Dritan Bici, Antoneta Dhima, Artemis Dralo (Malo), Xhevit Bushaj,

Mungojnë:

Anastas Angjeli, Vullnet Sinaj, Arben Elezi

Të ftuar:

Anila Denaj – Ministre e Financave dhe Ekonomisë

Elton Haxhi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Rovena Beqiraj – Përfaqësuese nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Alda Klosi - Përfaqësuese nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Endri Ducka - Përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ergys Misha - Përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Artan Shkreli - Zëvendësministër në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Teuta Balili – Drejtoreshë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Enea Karakaçi - Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Bledar Dervishaj - Këshilltar Ligjor i Presidentit

Krisilda Fana - Drejtore e Drejtorisë Juridike

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave. Kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes është i plotësuar.

Në rendin e ditës të mbledhjes së sotme kemi katër dekrete të Presidentit për të shqyrtuar. Do të fillojmë me dy dekretet që kanë lidhje me Ministrinë e Financave, si ministri përgjegjëse.

Çështja e parë është shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11226, datë 15. 7. 2019 “Për kthimin e ligjit nr. 37/2019 “Për disa shtesa në aktin normativ me fuqinë e ligjit nr. 4, datë 9. 7. 2008, të Këshillit të Ministrave “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore, ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros të këtyre ndërmarrjeve, miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24. 7. 2008, dhe ndryshuar ...

(Media, kameramanët, ju lutem mos bisedoni dhe mos bëni zhurmë! Mos bëni asnjë koment as tani dhe as gjatë seancës, sepse do t’ju nxjerrë jashtë!)

Çështja e dytë, që ka lidhje me Ministrinë përgjegjëse të Financave, është shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11251, datë 5. 8. 2019 “Për kthimin e ligjit nr. 50\2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125\2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”, të ndryshuar. Këto janë dy dekretet që kanë lidhje me Ministrinë e Financave.

Kemi të ftuar ministren e Financave, zonjën Denaj, e shoqëruar nga stafi i saj. Më pas do të diskutojmë dy dekretet që kanë lidhje me Ministrinë e Infrastrukturës, si autoritet kontraktor.

Çështja e tretë është shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11254, datë 8. 8. 2019, “Për kthimin e ligjit nr. 51/2019 “Për miratimin e kontratës së koncesionit/PPP, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si autoriteti kontraktor, dhe “Gjikuria”, sh.p.k., si koncesionari, dhe shoqërisë koncesionare “Rruga Orikum - Llogara”, sh.p.k., për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugës “Porti i Jahteve – bypass Orikum - Dukat (ura e Shën Elizës)””.

Çështja e katërt në axhendën tonë, por e dyta që ka lidhje me Ministrinë e Infrastrukturës, është shqyrtimi i Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11255, datë 8. 8.2019, “Për kthimin e ligjit nr. 52/2019 “Për miratimin e kontratës së koncesionit/PPP ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si autoriteti kontraktor, shoqërisë

“ANK”, sh.p.k., si koncesionari, dhe shoqërisë “Bardh konstruksion”, sh.p.k., si shoqëria koncesionare, për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor Milot – Balldren””.

Fillojmë diskutimin për dekretin, nr. 11226. Relatore është zonja Evis Kushi. Zonja Kushi, besoj se ju do të jeni shumë e shpejtë në logjikë, sepse ne e kemi diskutuar në detaje në një seancë këtu. Më pas do ta marrë fjalën ministrja dhe do të vazhdojmë me procedurën.

Evis Kushi – Faleminderit, kryetar!

Meqenëse është mbledhja e parë e komisionit për këtë sesion, uroj të gjithë kolegët, por edhe median, punë të mbarë në realizimin e objektivave tona të përbashkëta!

Për sa i takon dekretit të Presidentit që po shqyrtojmë sot, relacioni që do të prezantoj përmban në mënyrë të detajuar të gjitha argumentet dhe analizën ligjore që na çon ne në konkluzionin se dekreti i Presidentit dhe arsyetimi i tij janë të pabazuara dhe si i tillë ky dekret nuk mund të miratohet nga komisioni ynë. Prandaj, në fund, patjetër që do t’u sugjeroj të gjithë kolegëve që të mos e miratojmë.

Përpara se të ndalem në dy argumentet kryesore mbi bazën e të cilave Presidenti e ka kthyer për rishqyrtim ligjin nr. 37, të vitit 2019, dua të ndalem në një aspekt procedural, por që në vlerësimin tim është i rëndësishëm për të vërtetuar që analiza në dekretin e Presidentit nuk është e thelluar për të gjithë procedurën që ka ndjekur Kuvendi i Shqipërisë në miratimin e këtij ligji. E kam fjalën për faktin që në dekret përcaktohet që ligji është shqyrtuar nga Komisioni i Ligjeve në cilësinë e komisionit përgjegjës, madje, dekreti i Presidentit, citon herë-pas-herë pjesë nga raporti i Komisionit të Ligjeve.

E vërteta është që nuk ka qenë Komisioni i Ligjeve komisioni përgjegjës, por ka qenë pikërisht Komisioni për Ekonominë dhe Financat. Komisioni i Ligjeve e ka shqyrtuar atë ligj në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi. Kështu që, për këtë arsye është komisioni ynë për Ekonominë dhe Financat që shqyrton edhe sot dekretin e Presidentit.

Tani do të kaloj në dy argumentet bazë që ka përdorur Presidenti për të kthyer ligjin.

Së pari, Presidenti pretendon që akti normativ nr. 4 i vitit 2008 dhe ligji që ne kemi miratuar, i vitit 2019, janë dy akte që synojnë të rregullojnë çështje dhe problematika të ndryshme dhe nuk përmbajnë procedura të të njëjtës frymë që të garantojnë në nivel të njëjtë lirinë e veprimtarisë ekonomike. Ky është argumenti i parë, që në analizën tonë është i pabazuar. Kështu që, ne nuk mund ta miratojmë dekretin.

Cilat janë arsyet tona? Ligji që ne miratuam në vitin 2019 ka mundësuar thjesht ndryshime të nenit 2 të aktit normativ të vitit 2008. Pra, nuk mund të pretendojmë që janë dy akte të ndryshme dhe të pavarura, përkundrazi, ligji ynë, synon ndryshimin vetëm të një neni

të aktit normativ të vitit 2008, por pa ndryshuar dhe pa ndërhyrë aspak në qëllimin e ligjit bazë, në fushën e tij të rregullimit dhe në frymën e tij të përcaktuar në nenin 1 të këtij akti normativ.

Konkretisht, akti normativ parashikonte vetëm dy forma të privatizimit, që ishin ankandi dhe tenderi, ndërkohë ligji nr. 37 i vitit 2019, që ne miratuam, ofron edhe një formë tjetër, që është tjetërsimi, por duke përjashtuar kontratën e dhurimit, të cilën ne e kemi specifikuar qartë në ligjin nr. 37 të vitit 2019.

Pra, kjo ndërhyrje ka pasur si bazë prezencën e rasteve ose problematikën që është parë ndër vite, kur planet e zhvillimit parashikojnë kryerjen e investimeve në sipërfaqe toke, që janë kryesisht pronë private, por kanë një pjesë shumë të vogël pronësi shtetërore, e cila mund ta rrethojë, prekë kufizojë pjesën private. Kështu që, në këtë kontekst, ligji që ne miratuam i përgjigjet thjesht një problematike dhe nuk cenon interesin publik. Përkundrazi, cenim i interesit publik do të ishte në ato raste kur qeveria dhe ligjvënësi do të rrinin indiferentë ndaj problematikave të ndryshme të shfaqura, pra, ndaj pengesave që bëheshin për të zbatuar planet e zhvillimit urban.

Argumenti i dytë i Presidentit ka të bëjë me pretendimin që ligji që ne miratuam dhe që Presidenti ka sjellë për rishqyrtim, është në kundërshtim flagrant me ligjin e vitit 2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”. Sipas analizës që ka bërë Presidentit kjo situatë krijon mbivendosje të asaj që lejohet dhe asaj që ndalohet në kuadrin ligjor dhe mund të përbëjë rrezik për konflikt institucional.

Së pari, koncepti i tjetërsimit është një koncept juridik, që edhe vetë ligji i vitit 2001 “Për pronat e paluajtshme” e përmban, ashtu sikurse edhe Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë. Konkretisht, dispozita të cilës i referohet Presidenti është neni 3, pika 4: “Pronat e paluajtshme publike tjetërsohen ose jepen në përdorim sipas mënyrave dhe kufijve të përcaktuar me ligje të veçanta”.

Pra, duhet të përmbushen tre kushte. Kushti i parë është që duhet të ketë ligj të veçantë. Kushti i dytë është që ky ligj i veçantë duhet të përcaktojë mënyrat e tjetërsimit. Kushti i tretë është që duhet të përcaktohen kufijtë. Në kuadrin tonë ligjor përmbushen të tri kushtet.

Së pari, ligji nr. 37, që ne miratuam në vitin 2019 dhe që Presidenti e ka sjellë për rishqyrtim, është i veçantë. Në këtë aspekt plotësohet kushti i parë. Për sa i takon kushtit të dytë, në ligjin e vetëqeverisjes vendore, ligji që Presidenti pretendon se ka konflikt me ligjin tonë, përcaktohet qartë që miratimi dhe tjetërsimi ose dhënia në përdorim e pronave të të

tretëve, miratohen nga këshilli bashkiak. Pra, janë të qarta. Mënyrat si bëhen janë të përfshira në ligjin ekzistues Pra, edhe kushti i dytë është i qartë.

Gjithashtu, plotësohet edhe kushti i tretë, sepse në nenin 1 të ligjit të vitit 2019 janë përcaktuar kufijtë. Madje, është ky komision që bëri ndryshimet përkatëse në ligjin nr. 37 të vitit 2019, ku përcaktohet që pjesa shtetërore nuk duhet të jetë më e madhe se 20% e pronës që është e përfshirë në projektin e zhvillimit urban.

Kështu që, të tria kushtet që duhet të plotësohen nga ligji i vetëqeverisjes vendore janë të plotësuar, kështu që nuk mund të pretendojmë se ka kundërshtim flagrant ndërmjet ligjit të vetëqeverisjes vendore dhe ligjit aktual, të cilin ne po shqyrtojmë. Ndaj, nuk po zgjatëm më tepër.

Nisur nga të gjitha argumentet që parashtrova, që janë më të zgjeruara në relacionin e komisionit, dhe të gjithë anëtarët mund t'i kenë në dispozicion, është e qartë se arsyetimi i Presidentit dhe argumentet e tij janë të pabazuara, pra nuk qëndrojnë. Ndaj, u sugjeroj kolegëve të komisionit që të mos e miratojmë dekretin e Presidentit.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Përtej asaj që tha relatori, nëse nuk ka komente të tjera, zonja Denaj, nuk keni nevojë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anila Denaj – Shprehemi dakord. I qëndrojmë të njëjtit parim dhe mendojmë se të gjitha kushtet ligjore janë plotësuar.

Arben Ahmetaj – Në rregull. Faleminderit!

Ka ndonjë qëndrim nga përfaqësuesit e opozitës?

Korab Lita – Të gjesh argumente për t'i kthyer këto projektligje, tashmë të miratuara një herë në parlament, pra me dekret të kthyer nga Presidenti, sigurisht nuk duhet shumë punë, pasi ka argumente sa të duash për t'i kthyer.

Unë e përshëndes veprimin e Presidentit, jo sepse bie dakord me të, pasi për mua, në këndvështrimin politik, Presidenti është njësoj si edhe ju, pasi deri dje ka qenë në të njëjtën tavë me ju dhe i ka kaluar këto...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me ju të maxhorancës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në të njëjtën bashkëqeverisje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besoj se e kupton kaq.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka qenë deri dje! Por, të lutem, mos më ndërprit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, kur flas unë, nuk më ndërpret dot ti!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E pra, fjalën nuk ma mban dot ti!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, edhe dorën mos ma ngri! Kujdes! Mos ma ngri dorën mua!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëro, zotëri! Po pra, po flas, por, nëse ti më lë të flas, unë flas!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, por nuk më pengon dot!

Kështu që, jo, sepse besoj te vendosmëria e Presidentit për të ndaluar korrupsionin ose gjithçka që fshihet (afërë korruptive) pas këtyre koncesioneve, por, siç e thashë edhe më sipër, për pozicionin në të cilin ndodhet Presidenti, mendoj që i ka kthyer... Gjithsesi, unë e përshëndes vendimin e Presidentit, si dhe ftoj kolegët e opozitës të mos bëhen palë e këtyre aferave, pra për të gjitha koncesionet e kthyera në përgjithësi, dhe të votojnë pro dekretit të Presidentit.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Besoj se jeni i qartë që bëhet fjalë për shqyrtimin e dekretit “Për disa shtesa në aktin normativ...”, pra një, jo...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ah, e kishit për të gjitha. Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, nuk e kishit fjalën thjesht për ligjin.

Ka komente të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Faleminderit!

E hedhim në votim dekretin e Presidentit. Kush është pro?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një, dy, tre, katër, pesë. Kush është kundër dekretit të Presidentit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, dekreti i Presidentit rrëzohet në komision dhe i kalon seancës plenare për shqyrtim të mëtejshëm mbi këtë bazë.

Faleminderit!

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më 03.09.2019, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11251, datë 5.8.2019 “Për kthimin e ligjit nr. 50/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar””.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Evis Kushi, Senida Mesi, Blerina Gjylameti, Krenar Rryçi, Ervin Bushati, Reme Lala, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Suzana Topi, Korab Lita, Ardit Konomi, Sadi Vorpsi dhe Dritan Bici, Xhevit Bushaj, Antoneta Dhima, Artemis Dralo (Malo)

Mungojnë:

Anastas Angjeli, Vullnet Sinaj, Arben Elezi

Të ftuar:

Anila Denaj – Ministre e Financave dhe Ekonomisë

Elton Haxhi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Rovena Beqiraj – e Drejtorisë së Koncesioneve (PPP) në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Alda Klosi – Drejtoreshë e Drejtorisë së Koncesioneve (PPP) në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Endri Duçka – Drejtor i Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Ergys Misha – Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Pronës Publike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Artan Shkreli – Zëvendësministër i Infrastrukturës

Teuta Balili – Drejtoreshë e Programeve të Zhvillimit të Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Urban në Ministrinë e Infrastrukturës

Enea Karakaçi – Drejtor i Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Infrastrukturës

Bledar Dervishaj – Këshilltar Ligjor i Presidentit të Republikës

Krisilda Fana – Drejtoreshë Juridike në institucionin e Presidencës

Arben Ahmetaj – Kalojmë te dekreti nr. 2 i Presidentit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka gjë, se e kam këtu materialin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

U lutem përfaqësuesve të medias të mbajnë qetësi, edhe ju gazetarëve prapa ministres!

Pra, dekreti nr. 2, që vjen për rishqyrtim në Kuvend, ka të bëjë me kthimin e ligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat””.

Dua t’u kujtoj qytetarëve dhe anëtarëve të komisionit, si dhe medias se ndryshimet në këtë ligj kanë konsistuar në limitimin e përdorimit të ofertës së pakërkuar nga ana e autoriteteve kontraktuale. Kjo ka qenë një nismë e Ministrisë së Financave, e imja personalisht dhe e Kryeministrit, për ta hequr këtë mundësi, pra ofertën e pakërkuar, nga ligji. Besoj se ka qenë dhe është e qartë edhe në ligj, si dhe në amendamentin që unë kam bërë, të cilit Presidenti i është referuar edhe në dekret, për kujtesën tuaj, ligji ka kaluar në Kuvend në fund të korrikut. Draftligji është futur në seancë plenare shumë më vonë sesa e ka shqyrtuar komisioni (ne e kemi shqyrtuar në shkurt, ndërkohë që është futur në korrik); data e hyrjes në fuqi ka qenë 1 korriku. Amendamenti im ka qenë që ligji të mos ketë fuqi prapavepruese, pra nga fundi i korrikut në datën 1 korrik, por kemi vënë 1 tetorin, që përkonte edhe me të gjithë procedurën e shqyrtimit nga ana e Presidentit, të hyrjes në fuqi, të botimit në Fletoren Zyrtare. Gjithsesi, Presidenti e ka përdorur si argument për ta kthyer.

Amendamenti im ka kaluar në komision, është votuar pro nga ky i fundit, është përfshirë në seancë plenare dhe është votuar nga Kuvendi. Kjo është logjika kronologjike që kur je në datën 30 korrik nuk mund të quash datën 1 korrik të po atij muaji, të po atij viti për hyrjen në fuqi. Kështu që, praktikisht, edhe vetë e besoj se ka qenë një lloj invencioni nga ana e zyrës së Presidentit për të gjetur një arsye për ta kthyer një ligj kaq të domosdoshëm, që u është referuar me kujdes edhe praktikave dhe sugjerimeve të Bankës Botërore, FMN-së dhe SIGMA-s. Ndërkohë, ky ligj përforcon edhe rolin e Ministrisë së Financave, e cila në partneritetin publik-privat (koncesione) nuk është autoritet kontraktor, por kujdeset për balancimin fiskal. Në këtë ligj u kemi dhënë një përgjegjësi më shumë kontratave që edhe ato, që nuk kanë nevojë për mbështetje buxhetore, të kalojnë në Ministrinë e Financave për t'i referuar me kujdes, nëse mund të ketë ndonjë detyrim kontingjent ose, e thënë ndryshe për qytetarët, detyrime të fshehura, që mund të materializohen nga risqe të mundshme në materializim risqesh në një kohë të dytë. Për këtë gjë Ministria e Financave duhet të jetë alerte, sepse mund të cenojë balancën fiskale. Kjo është logjika që kemi përdorur.

Unë nuk do ta lexoj fije për pe të gjithë argumentimin që ka bërë Shërbimi i Kuvendit, komisioni këtu, pasi besoj që është shumë i qartë. ndaj nuk po vazhdoj më gjatë me shpjegimet.

Në qoftë se ministrja ka diçka për të shtuar lidhur me këto që thamë, është e ftuar të flasë. Nëse jo, besoj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zonja Ministre.

Anila Denaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, dua të them vetëm diçka, për të qenë në të njëjtën linjë: i njëjti argument, që u përdor dhe u argumentua në muajin shkurt pse u shty në datën 1 korrik, ishte sepse ne, si Ministri e Financave, dhe të gjitha institucionet kishim nevojë për kohë disajavore, tremujore. Pra, i njëjti argument vlen edhe sot.

Në momentin kur aprovet një ligj, çdo institucion ka kohë në dispozicion për të përgatitur aktet nënligjore dhe për t'i bërë ato transparente dhe të hapura për të gjitha institucionet ligjzbatuese.

Ne i mbetemi të njëjtit propozim dhe kërkojmë të mos aprovet ky ndryshim.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Ka ndonjë koment nga pozita?

Po, zonjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edlira Hyseni – Përsëndetje!

Lidhur me dekretin që Presidenti e ka kthyer për rishqyrtim për ligjin e koncesioneve, për sa unë e lexova shpjegimin që ka dhënë, ai përqendrohet tek ato, që edhe ju i përmbledhët shkurtimisht. Në fakt, mbetet ende pak i diskutueshëm dhe jo bindës argumenti pse një ligj kaq i rëndësishëm është propozuar që në janar të vitit 2019, ka kaluar në komision (është shqyrtuar në shkurt të po këtij viti) dhe është kaluar pastaj për miratim në seancën e fundit plenare të datës 18.07.2019.

Kohën që ju është dashur, besoj se e keni pasur në dispozicion edhe më përpara, kur ligji kaloi në komision në shkurt, kur ne nuk kemi qenë këtu.

E para, nuk e shoh ende të qartë përgjigjen pse u vonua miratimi i këtij ligji dhe pse u la kaq kohë e gjatë që nga shkurti, kur u miratua në komision, deri në korrik, kur ai kaloi në seancë plenare.

E dyta...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Kë po pyet? Po bëni pyetje?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edlira Hyseni – Jo, quajeni pyetje, por opinion më thatë!

Unë po shpreh një opinion.

Arben Ahmetaj – Pra, nuk po ia drejtoni pyetjen dikujt, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edlira Hyseni – Në qoftë se pastaj më përgjigjet ministrja...

Arben Ahmetaj – Ministrja nuk ka punë me Kuvendin.

Edlira Hyseni – Në rregull.

Arben Ahmetaj – Ministrja është anëtare qeverie.

Edlira Hyseni – Jo, ministrja u prononcua pikërisht për afatin pse u vonua nga shkurti në korrik.

Arben Ahmetaj – Por nuk është faji i ministres, është faji i Kuvendit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë!

Edlira Hyseni – Nuk e pata të qartë argumentin që ngre Presidenti dhe nuk e kuptoj ende përgjigjen pse u vonua nga shkurti në komision, në korrik në miratim... Personalisht nuk e kam të qartë. Megjithatë, po nuk është pyetje, le të merret si opinion.

Kam edhe një pyetje tjetër. Presidenti vë në diskutim nenet 17 dhe 18, që janë propozimet dhe amendimet që bëri zoti Ahmetaj, ku thekson faktin që janë bërë 24 orë përpara dhe diskutohet afati i këtij ligji. Besoj se biem dakord që ky ligj është shumë i rëndësishëm dhe ka hequr ofertën e pakërkuar, aq shumë të diskutueshme dhe, që, në fakt, lidhet me dy koncesionet, për të cilët do të flasim më tutje. Me ligjin që u miratua, afati u shty më 1 tetor të vitit 2019 dhe dilema lind: a parashikoni ose a keni mundësi të na thoni nëse deri më 1 tetor të vitit 2019 do të ketë kërkesa të reja (oferta të pakërkua) dhe kontrata të reja koncesionare ose partneritet publik-privat, që do të jenë në shqyrtim ose eventualisht mund të miratohen, mund të merren në konsideratë, meqenëse ligji që ju miratuat, që Kuvendi miratoi, e ka shtyrë afatin më 1 tetor? Kjo do të thotë se ka ende kohë që të krijohen, të miratohen ose të firmosen kontrata të reja.

Tani, duke qenë se tashmë diskutohen shumë ato kontrata që tashmë janë. Efektivisht, zgjatja e afatit deri më 1 tetor, a jua ka dhënë këtë mundësi? A janë projektet e reja që fliten tani për muajt korrik, gusht, shtator në mënyrë që ne të dimë që ky ligj u ka dhënë mundësinë të krijohen këto PPP-të e reja?

Ministria e Financave e ka si detyrim të shprehet zyrtarisht për të gjitha koncesionet e partneritetit publik-privat. Në dy dekretet e mëpasshme, ku ju nuk jeni të pranishëm, por do të jetë Ministria e Infrastrukturës, një nga pikat që ka ngritur Presidenti si shqetësim është që Ministria e Financave për dy koncesionet e Milot-Balldren dhe Orikum-Dukat nuk ka një shkresë zyrtare ku Ministria e Financave të jetë prononcuar dhe të ketë një miratim apo një qëndrim të vetin lidhur me këto dy koncesione që i përkasin të njëjtës formës si ligji që jemi diskutuar.

A e ka detyrimin Ministria e Financave dhe a e ka ushtruar këtë drejtë për të dhënë një prononcim në lidhje me koncesionet qoftë në tërësi apo qoftë për dy dekretet që ne do të diskutojmë më pas, pasi ju nuk do të jeni pranishëm dhe për këtë arsye do të doja të dija mendimin tuaj?

Arben Ahmetaj – Më falni, por jemi duke folur për dekretin nr. 11...

Edlira Hyseni – Në përgjithësi...

Arben Ahmetaj – Kur të vijmë te çështjet specifike, sepse pyetja që ju bëtë ishte specifike...

Edlira Hyseni – Do të doja ta dija në tërësi Ministria e Financave për çdo koncesion, për çdo...

Arben Ahmetaj – Më falni, zonjë, sepse në qoftë se unë do të lejoja që të flitej për të gjitha ligjet njëherësh, atëherë këtu nuk do të kemi procedurë parlamentare...

Edlira Hyseni – Unë përfitova të pyes nga momenti meqë ishin të pranishëm përfaqësuesit...

Arben Ahmetaj – Kur të vijnë...

Edlira Hyseni – Ndoshta nuk do të jenë?

Arben Ahmetaj – Ku e di ti?

Edlira Hyseni – Sepse ju thatë që do të jenë përfaqësuesit e ministrisë tjetër...

Arben Ahmetaj – Nga e dini ju që ata do të ikin, sepse unë kam një procedurë parlamentare dhe do ta zbatoj?

Edlira Hyseni – Në rregull, nëse ata munden, mirë. Në të kundërt nuk ka ndonjë problem.

Arben Ahmetaj – Do t'ju kërkoja të mos bëni pyetje për ligje që do të diskutohen më vonë.

Edlira Hyseni – Unë përfitova nga rasti meqë ata ishin prezent.

Ju faleminderit!

Arben Ahmetaj – A ka ndonjë koment për sa i përket...

(Diskutime pa mikrofon)

Ju jeni anëtar i këtij komisioni?

Alban Zeneli – Qytetar i thjeshtë

Arben Ahmetaj – Alban, ju lutem uluni, në këmb nuk flitet, uluni merrni pjesë në komision, bëj pyetje, sepse në këmbë nuk flitet!

(Diskutime pa mikrofon)

Alban Zeneli – Ti mos më thuaj mua kush je ti...

(Diskutime pa mikrofon)

Arben Ahmetaj - Ju lutem uluni dhe merrni pjesë në mbledhje, ngri cështje,

Alban Zeneli – Nuk do të pyes ty unë ulem a nuk ulem

Arben Ahmetaj – Atëherë unë e mbyll komisionin...

(Diskutime pa mikrofon)

Më falni, mbledhja mbyllet deri sa të vendoset rregulli.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – A ka ndonjë përgjigje sa i përket dekretit nr. 11 251 që ka të bëjë me kthimin e ligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat””.

Anila Denaj - Faleminderit, zoti kryetar!

Kisha një sqarim në raport me afatin. Ministria e Financave sqaron vetëm afatet, që janë përgjegjësi dhe kompetencë e saj, jo afatet e tjera. Ne kemi shprehur arsyet tona që në momentin që është shqyrtuar ky projektligj për një kohë të caktuar për të përcaktuar kuadrin rregullator pas hyrjes në fuqi të ligjit dhe kjo kohë është e domosdoshme dhe është në të njëjtin afat kohor që është propozuar.

Një pyetje tjetër, që u adresua, ishte për projektet e tjera. Dua t'ju them se nuk ka projekte të tjera. Ne do të vazhdojmë të jemi transparent nëpërmjet të gjitha institucioneve të varësisë dhe do t'ju dhënë sqarime në vijim.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – A ka ndonjë tjetër që do ta marrë fjalën?

Po.

Artur Roshi – Unë e vlerësoj qëndrimin e Presidentit të Republikës me këtë dekret për kthimin prapa të këtij projektligji. Presidenti i Republikës nuk është armiku i popullit dhe as i pushtetit, prandaj kjo gjë duhet parë me qetësi dhe logjikë. Nëse në ligj thuhet që e shtrin efektin deri në tetor të vitit 2019, atëherë nuk kemi pse ta miratojmë tani. Ne kemi mjaft kohë deri në muajin tetor për ta bërë këtë gjë, por kjo gjë tregon se pas kësaj fshihet qëllimi real i qeverisë, e cila ka ndër mend që deri në muajin tetor të 2019-s të kalojë disa koncesione, sepse i kanë mbetur merak disa njerëz që duhet të bëhen pjesë e oligarkisë dhe të përfitojnë në mënyrë të padenjë paratë e shqiptarëve dhe të taksave të tyre, të cilat janë sipas këtyre ofertave dhe kërkesave të pakërkuara.

Ofertat të pakërkuara dhe të kërkuara vetëm nga ai që do të përfitojë para gjejnë logjikë vetëm këtu në Kuvendin e Shqipërisë. Unë mendoj se nuk ka asnjë lloj opionence apo fizibiliteti, por ka vetëm oferta të pakërkuara. Pra, del dikush që do të bëhet me para, dikush që thotë se unë kam lindur me këmishë dhe do të bëhem milioner brenda natës, sepse kam për të bërë një partneritet me qeverinë, me paratë e buxhetit të shqiptarëve, por këto pasoja do t'i vuajnë edhe fëmijët tanë këtu e 30 vjet më vonë. Unë e çmoj me vend dekretin e Presidentit, duhet të ndryshojmë afatin, i cili nuk duhet të bëjë të mundur edhe kalimin e dy koncesioneve që kemi në dorë, atë të Llogorasë dhe të Milotit.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – A ka ndonjë koment tjetër? Jo.

Hedhim në votim dekretin e Presidentit të Republikës nr. 11251, datë 05.08.2019 për kthimin e ligjit nr. 50/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”, të ndryshuar”.

Kush është pro dekretit? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Dekreti i Presidentit rrëzohet. Vendimmarrjen tonë ia kalojmë seancës plenare për shqyrtim në bazë të procedurave parlamentare.

Faleminderit, zonja Ministre!

Unë mendoj se ndonjë anëtar i stafit tuaj do të jetë i pranishëm së bashku me stafin e Ministrisë së Infrastrukturës, apo jo?

Faleminderit!

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 03.09.2019, ora 10.30

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj– Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11254, datë 08.08.2019, “Për kthimin e ligjit nr. 51/2019 “Për miratimin e kontratës së koncesionit/PPP ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si autoriteti kontraktor, dhe “Gjikuria”, sh.p.k., si koncesionari, dhe shoqërisë koncesionare “Rruga Orikum - Llogara”, sh.p.k., për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugës “Porti i jahteve - By-Pass Orikum - Dukat (ura e Shën Elizës)””.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Evis Kushi, Senida Mesi, Blerina Gjylameti, Krenar Ryci, Ervin Bushati, Reme Lala, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Suzana Topi, Korab Lita, Ardit Konomi, Sadi Vorpsi dhe Dritan Bici, Xhevit Bushaj, Antoneta Dhima, Artemis Dralo (Malo)

Mungojnë:

Anastas Angjeli, Vullnet Sinaj, Arben Elezi

Të ftuar:

Anila Denaj – Ministre e Financave dhe Ekonomisë

Elton Haxhi- Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Rovena Beqiraj – përfaqësuese e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Alda Klosi - përfaqësuese e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Endri Ducka - përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Ergys Misha - përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Artan Shkreli – Zëvendësministër i Infrastrukturës

Teuta Balili - Drejtore në Ministrinë e Infrastrukturës

Enea Karakaçi – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës

Bledar Dervishaj - Këshilltar Ligjor i Presidentit

Krisilda Fana - Drejore e Drejtorise Juridike në Presidencë

Arben Ahmetaj – Pika e tretë e rendit të ditës është shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11254, datë 08.08.2011 për kthimin e ligjit nr. 51/2019 “Për miratimin e koncesionit PPP ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si autoritet kontraktor dhe “Gjikuria sh.p.k.” si koncesionari dhe shoqërisë koncesionare rruga Orikum-Llogara sh.p.k për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugës “Porti i jahteve” *by pass* Orikum-Dukat (Ura e Shën Elizës). Relatore është zonja Blerina Gjylameti.

Zonja Gjylameti, fjala për ju.

Blerina Gjylameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Do t’ju flas shkurtimisht për argumentet kundër që kemi kundrejt dekretit të Presidentit për projektligjin në fjalë.

Në fillim do t’ju rendis pjesën e arsyeve se pse Presidenti i Republikës e ka kthyer për rishqyrtim ligjin dhe po ashtu edhe argumentet tona kundër.

Së pari, nuk evidentohet ndonjë akt i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për miratimin financiar të këtij projekti. Lidhur me këtë çështje theksoj se projekti për ndërtimin dhe operimin e rrugës Orikum-Dukat, i cili është parashikuar në projektbuxhetin afatmesëm 2019-2021, i propozuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe i miratuar nga Këshilli i Ministrave, i është paraqitur Kuvendit. Vlen t’ju theksoj, edhe pse e di që është një fakt i ditur, që kur flasim për Këshillin e Ministrave, i cili ka paraqitur në Kuvend për miratim projektligjin për miratimin e kësaj kontrate, vlen të theksohet që Ministria e Financave është pjesë e Këshillit të Ministrave. Për sa kohë është pjesë e strukturës mendoj se e ka miratuar kontratën e koncesionit të PPP-ve, megjithatë një informacion më të plotë për aktin e miratimit të kësaj kontrate duhet të na jepet nga përfaqësuesit e kësaj ministrie.

Së dyti, argumentimi që ka renditur Presidenti i Republikës ka të bëjë me paqartësinë, mungesën e transparencës dhe bazueshmërinë ligjore në vlerësimin e projektit të koncesionit PPP. Mungon një studim fizibiliteti i plotë dhe objektiv, si dhe vlera e kontratës është e lartë.

Lidhur me vlerën e projektit janë paraqitur disa vlerësime në faza të ndryshme.

E para, ka të bëjë me koston fillestare të projektit e parashikuar në buletin e njoftimeve publike.

E dyta, oferta fillestare e shoqërisë koncesionare.

E treta, vlera e projektit pas negocimit nëpërmjet palëve, që është një vlerë më poshtë sesa vlera e ofertës fillestare të shoqërisë.

Pra, vlera e projektit është më e lartë se kostoja fillestare e publikuar nga autoriteti kontraktor për konkurrim dhe më pas gjatë negocimit të kontratës vlera e saj është reduktuar. Po sipas Presidentit, negocimi i kontratës është në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe dokumentet standarde të tenderit.

Unë mendoj se propozuesit e projektligjit duhet të informojnë komisionin për faktorët, që kanë ndikuar në rritjen e vlerës së projektit krahasuar me parashikimin fillestar. Pra, të rendisin të gjitha ndryshimet që kanë të bëjnë me përmirësimet e projektit, që lidhen me gjatësinë dhe cilësinë e rrugës, veprat e artit apo edhe fajtorë të tjerë. Megjithëse vlera e projektit është reduktuar gjatë negociatave ndërmjet palëve mendoj që nevojitet informacion shtesë për bazën ligjore përkatëse, ku janë bazuar për negocimin. Gjithashtu, në dekret kemi në tjetër element, që ka të bëjë me theksimin se vlera fillestare duhej të paraqitej si vlerë e plotë për të krijuar të gjithë ofertuesve potencial mundësinë e konkurrimit.

Përsëri nga ana e ministrisë, propozuesit e projektligjit, mendoj se duhet të rendisin informacionin përkatës në lidhje me këtë çështje.

Ndër të tjera në dekret theksohet se institucionet ndërkombëtare financiare kanë rekomanduar eliminimin e menjëhershëm të propozimeve të pakërkuara. Atëherë, mendoj se këtu duhet theksuar fakti se miratimi i kontratës së koncensionit në këtë procedurë është në përputhje me kuadrin ligjor aktual. Gjithashtu, Kufizimi procedurës, sikundër e përmendëm më parë, ka të bëjë me një moment të dytë, pra me datën 1 tetor të vitit 2019, ku hyn në fuqi edhe ligji për koncesionet e miratuar së fundi nga Kuvendi.

Si përfundim, mendoj se të gjitha argumente që ka renditur Presidenti për të rikthyer këtë projektligj janë argumente, të cilat nuk qëndrojnë. Duke u bazuar edhe në informacionin që ministria propozuese e këtij projektligji do të na japë, mendoj dhe i ftoj të gjithë anëtarët e komisionit të mos e miratojmë dekretin e Presidentit.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Kush e do fjalën?

Artur Roshi - Problemi këtu është se qëndrimet duhet të jenë të arsyetueshme dhe stabël dhe nuk duhet të mbajmë thjesht qëndrime politike. Në fakt, është një dëm i madh që u bëhet taksapaguesve shqiptarë. Kjo qeveri, brenda mandatit të saj, ka të drejtë të qeverisë shqiptarët, por nuk ka të drejtë të shpenzojë paratë e shqiptarëve para se ata t'i fitojnë. Prandaj, ne nuk e dimë se si do të ecë ekonomia shqiptare pas 2 apo 3 vjetësh dhe qeveria nuk

mund të parashikojë sot sesi do t'i harxhojë paratë, të cilat nuk i janë fituar ende. Pra, ka një nonsens logjik.

Së dyti, unë mendoj se koncesionet janë njëlloj si firmat piramidale, por vetëm se sistemi piramidal ndodh ndër vite dhe nuk ka nivelet numerike të tij. Pra, deri dje firma piramida e Sudes ishte duke shtuar numrin e njerëzve në nivele të caktuara, kurse sot kemi të kundërtën, pra kemi rrafshet kohore për paratë që i merren buxhetit dhe të ardhurat e shqiptarëve në vitet që do të vijnë. Edhe kjo është për një periudhë të caktuar, aq sa mendon qeveria se mund të kënaqë interesat e një klani të caktuar biznesi apo një kompanie të caktuar. Pra, nuk ka fizibilitet, nuk ka logjikë ekonomike, nuk ka logjikë biznesi, nuk di çfarë t'i quaj, nuk ka biznese në treg që të mos njohin riskun, sepse PPP-të vijnë si biznese dhe e nuk njohin riskun. Ku është risku këtu? Zero. Mendoj se në këta 6 vjet Partia Socialiste dhe qeveria kanë bërë vetëm investime abstrakte, investime që nuk kanë impakt ekonomik dhe, sigurisht, në vazhden e këtyre janë edhe PPP-të. Të ndalosh këto koncensione me ligj në mesin e tetorit të vitit 2019 është njëlloj sikur të thuash që do të ndalojmë dhënien e PPP-ve pasi qeveria të largohet nga qeverisja.

PPP-të janë një çmenduri ekonomike e institucionalizuar në një nivel financiar, publik dhe efekti i tyre është negativ për të ardhmen tonë. Në këtë rast paguhet dy herë: një herë paguhet përqindja, që merr i ashtuquajtur biznesmen, sepse nuk janë biznesmenë nga bankat e nivelit të dytë nëpërmjet kontratës koncensionare, dhe, një herë, i paguhet përqindja po këtij biznesmeni që presupozohet se i merren paratë me qira. Të gjithë këta biznesmenë nuk kanë kapitale në bankë. Edhe sikur këta biznesmenë të ishin të huaj, përsëri do të kishte pikëpyetje të mëdha dhe hije dyshimi, aq më tepër që këta janë të gjithë shqiptarë dhe ne i dimë kapitalet e tyre. Madje edhe në materialet e tyre nuk kanë as 1/4-ën apo 1/5-ën e investimit që kryhet. Atëherë, kush është ky person, sepse kështu mund të jenë rreth një milion shqiptarë, që mund të marrin koncensione dhe të ndërtojnë me paratë e bankave shqiptare. Pse duhet të jenë këta persona? Kjo është për sa i përket konkurrencës.

Së dyti, paguhet dy herë interesa. Pra, edhe interesat e bankës, edhe interesat e privatit. Kjo është nonsens, sepse nëse do t'i jepnim koncension një kompanie të huaj, atëherë do të paguanim vetëm interesin e individëve apo të një kompanie, jo të markës. Kështu, në çdo rresht ky projektligj është një marrëzi e vërtetë, duket se nuk ka logjikë, por është thjesht emocioni dhe imagjinata e Kryeministrit për të qeverisur dhe për të bërë gjoja objekte publike.

Kryeministri çuditet kur kalon në rrugën Dibrës dhe e prezanton atë projekt duke thënë: "Shikoni se çfarë bën sektori privat!". Nuk ka ndërtim që nuk bëhet, por janë paratë

ato që duhen për të realizuar vepra. Çdo lloj ndërtimi bëhet, problemi qëndron vetëm te kostoja e këtij ndërtimi. Pra, qeveria bën investime me çmime në stratosferë dhe nuk njih tërheqje nga kjo gjë, nuk njih vetëpërmbytje, në një kohë që nuk ka fizibilitete, nuk ka preventiva krahasuese, madje edhe supervisorët i vendosin vetë konkensionarët. Si është e mundur që konkensionari të vendosë supervizionin e tij, pra ta paguaj vetë atë dhe jo qeveria?! Si ka mundësi që mirëmbajtja e konkensionit fillon direkt pas mbarimit të investimit?! Të gjithë e dimë se çdo investim ka garanci, apo jo? Këtu garancia është zero. Pse sa mbaron investimi, që të nesërmen fillon mirëmbajtja?! Kjo nuk ka sens. Çfarë këto gjëra?

Ti shkon dhe blen një orendi shtëpiake dhe të ke garanci një apo tre kanë garanci muaj, pra çdo produkt ka garanci, ndërkohë që investimi këtu nuk paska asnjë garanci. Pse milionat e eurove që hidhen nuk paskan garanci?

Pse nuk ka studime që janë këto segmente dhe nuk janë segmente të tjera? Kush është impakti që do të japë në ekonomi ky lloj koncesioni? Nuk ka përgjigje. Pse rruga e Llogorasë dhe jo rruga e Skraparit, meqenëse ju keni kunj edhe me Presidentin. Pse? Nuk ka logjikë. Kush është impakti që jep kjo gjë në turizëm? Ne e kemi parë se kush cili ka qenë edhe impenjim i qeverisë për turizmin. E kemi parë me taksat, me grupet që nxjerr Ministria e Financave, duke i gjobitur në mënyrë të padrejtë të gjitha bizneset, duke u marrë me çdo shezlon dhe me çdo dhomë hoteli. Prandaj, këto janë banalitete dhe vulgaritete, që unë them se nuk duhen të jenë pjesë e qeverisjes për vitet që jetojmë. Pra, kjo nuk ka të bëjë me qëndrimin tonë politik. Ajo që neve duhet të na bashkojë është logjika. Pra, kur flasim për gjëra inxhinjerieke duhet të qëndrojmë tek ato, edhe kur flasim për preventiva duhet të qëndrojmë tek ato, sepse nuk dua të futem te çmimet e tyre. A e dini si janë çmimet e tyre? Ato janë miratuar nga Ministria e Infrastrukturës në vitin 2015 dhe të paktën janë 40% më të shtrenjta se sa tregu. Këtu po flas për analizën e çmimeve. Pra, a nuk u mjafton kjo konkensionarëve, por kërkojnë që sërish t'i fryjnë preventivat e tyre 3 apo 4 herë, sepse më e pakta është 2 herë? Kështu që ju ftoj, pavarësisht qëndrimit emocional që keni për Presidentin, që të votojmë pro dekretit për t'i rrëzuar këto konkencione. Është mirë që të kemi në koshiençën tonë një lloj rregulli për të vepruar dhe ju ftoj të gjithëve ta bëjmë këtë gjë.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Ju lutem, mund të flisni shkurt, sepse e lejova deputetin të fliste pa limit kohe! Gjithashtu, do t'ju lutesha që të respektonim një limit kohor sipas procedurës dhe Rregullores dhe të qëndrojmë brenda axhendës.

Edlira Hyseni - Atëherë, unë do të përpiqem të sintetizoj dekretin e Presidentit dhe po i bëj unë pyetjet që Presidenti jua ka drejtuar në kërkesën e tij për informacion dhe nuk ka marrë ende përgjigje. Meqenëse, ju jeni autoriteti përgjegjës mbase sqarojmë diçka më shumë se çfarë është përcaktuar në dekret.

Pyetja e parë dhe e thjeshtë dhe që Presidenti ka ngritur është: a është miratuar PPP-ja e segmentit Oriku-Dukat? Pra, kjo kontratë e kësaj rruge, a ka një miratuar dhe a është publikuar me shkresë zyrtare nga Ministria e Financave për sa kohë flasim për një kontratë me një vlerë 67 milionë euro? Pra, edhe pse Ministria e Infrastrukturës është autoriteti kontraktues, e cila ka parë domosdoshmërinë e ndërtimit të kësaj rruge, në fund të fundit është Ministria e Financave që do të menaxhojë kostot dhe përfitimet e këtij projekti, por edhe Presidenti thotë se nuk ka një dokument zyrtar. Prandaj unë ju pyes zyrtarisht a e ka miratuar Ministria e Financave projektin PPP për ndërtimin e rrugës Oriku – Dukat? Pyetja e parë.

Pyetja e dytë ose çështja e dytë që ngre Presidenti lidhet me vlerën fillestare të projektit, e cila ka qenë rreth 50.5 milionë euro dhe arritjes në çmimin përfundimtar me 67 milionë euro. Pra, autoriteti përgjegjës fillimisht këtë projekt e ka llogaritur se mund të kushtojë diku te 50 milionë euro, si u arrit në një çmim përfundimtar me 16 milionë euro më shumë sesa vlera fillestare e preventivuar nga ju? Sipas dekretit që ka bërë një analizë të këtij projekti thuhet se nga dokumentacioni i parë nuk duhet të kishte qenë një vlerë e negociueshme. Pra, nëse do të ishte negociuar, çmimi do të ishte ulur dhe jo rritur, prandaj duhet të ketë një shpjegim se pse u rrit vlera me 16 milionë euro më shumë.

Çështja tjetër që qëndron, e cila përbën edhe opinionin tonë kundër kur këto ligje kaluan në parlament, lidhet me bazën krahasuese. Pra, ky projekt mundet të kushtojë realisht 67 mijë euro, por a kanë autoritetet përgjegjëse një studim për të bërë një krahasim se sa do t'i kishte kushtuar shtetit nëse do ta bënte vetë dhe sa i kushtoi duke e bërë shoqëria koncesionare? Pra, duke krahasuar dy preventivat ose më shumë të arrihet në konkluzionin se cili është më i leverdishmi.

Pyetja e fundit, meqenëse kanë kaluar 2 – 3 muaj që po diskutohet ky projekt, a keni informacione më të detajuara lidhur me kostot e këtij projekti? A e dini se sa është kostoja për një kilometër dhe për 3 urat e famshme, të cilat ju thoni se janë vepra arti? Kur ju thoni: “vepër arti”, mua më bëhet mishi kokërr, sepse ne në Durrës kemi Velierën si vepër arti, e cila ka kushtuar miliona euro. Meqenëse kostot e këtyre veprave arti mbeten të diskutueshme, sepse çmimin mund ta vendos secili sa të dojë, a mund të na thoni se sa do të kushtojë secila urë, sa kushton një kilometër dhe sa janë zërat e këtij preventivi?

Unë përsëri jam kundër këtij koncesioni të dhënë me PPP, jo se nuk është i domosdoshëm e i nevojshëm, këtë nuk e vë në diskutim, sepse do të përmirësojë infrastrukturën e asaj zone turistike dhe se është në të mirë të vendit tonë, por lidhur me çmimin, kostot, analizën dhe me përzgjedhjen e firmës fituese unë mbetem shumë skeptike, prandaj do të dëshiroja që ky projekt të ribëhet me ndryshimin e ligjit, që është bërë me ofertën e pakërkuar, pra të rishikohet dhe me siguri do të gjendet një mundësi për ta bërë atë më lirë dhe shqiptarët të paguajnë më pak, për të njëjtën vepër publike.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Fjalën e ka përfaqësuesi i ministrisë për pyetjet e deputetes.

Artan Shkreli – Po filloj me pyetjet e zotit Roshi dhe pastaj me pyetjet e zonjës Hyseni.

Arben Ahmetaj – Zoti zëvendësministër, filloni me pyetjet që bëri zonja, sepse zoti Roshi nuk bëri pyetje.

Artan Shkreli – Në lidhje me pyetjen se përse nuk ka pasur komunikim me Ministrinë e Financave në raport me këtë projekt, zonja Hyseni i referohet shkresës së Presidentit dhe nuk i referohet dokumentacionit tonë, i cili tregon shumë qartë se ky koncesion është dërguar për mendim pranë Ministrisë së Financave me anë të shkresës së bërë në datën 10.05.2019 dhe shkresës me kthimin e përgjigjes në datën 14.05.2019, e cila tregon se kjo ministri është dakord me këtë kontratë. Pra, një gjë e tillë ekziston. Shkresat janë të protokolluara dhe të depozituara, bashkëlidhur është edhe komunikimi zyrtar nëpërmjet ministrive. Këtu janë të gjitha: vlera e ndërtimit, procedura, metodika e të tjerë. Ministria e Financave është shprehur dakord me këtë koncesion.

Për sa i përket vlerës së investimit, unë po ia lë fjalën specialistes, e cila është marrë me negocimin e kontratës, që është në gjendje të japë edhe shifra, meqenëse i kërkon.

Teuta Balili – Atëherë në lidhje me...

Arben Ahmetaj – Më falni po lejen për të folur nuk e jep zëvendësministri, por e jap unë. Proceduarën nuk e drejton zëvendësministri, por kryetari i komisionit.

Artan Shkreli – Po, është e qartë, por ngaqë e konsiderova si palë, sepse jemi në një ministri.

Arben Ahmetaj – Brenda ministrisë mund të jepni urdhra, por jo këtu.

Artan Shkreli – Unë nuk jap urdhra, sepse...

Arben Ahmetaj – Të lutem, zoti zëvendësministër, po, zonja Teuta mund të vazhdoni.

Teuta Balili – Referuar projektit të jahteve Orikum – Dukat, vlera fillestare e këtij projekti ka qenë 70 milionë e 120 mijë euro, në të cilën përveç vlerës së mësipërme të ndërtimit dhe mirëmbajtjes është edhe totali i interesave të burimit të financimit të këtij projekti.

Gjatë procesit të negocimit me ofertuesin, pra me fituesin e këtij koncesioni, vetë ofertuesi ka deklaruar pranë autoritetit kontraktues një ulje të vlerës së projektit, e cila nuk prek cilësinë e ndërtimit të këtij projekti.

Referuar viteve të ndërtimit dhe mirëmbajtjes, fillimi i mirëmbajtjes së kësaj rruge nuk fillon njëkohësisht me vitin e fillimit të ndërtimit, por pasi përfundon 4-vjeçari i ndërtimit të rrugës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Nuk mund të merret fjala kështu, të lutem, lëreni të mbarojë.

Po, zonja Teuta.

Teuta Balili – Referuar kontratës së koncesionit, autoriteti kontraktues dhe ofertuesi kanë rënë dakord me vlerën e propozuar nga ofertuesi fitues. Në këtë rast ne nuk kemi një rritje të vlerës për ndërtimin e projektit, por kemi ulje, pra nga 70 milionë që ka qenë vlera fillestar është ulur në 67 milionë 359 mijë e 926, plus TVSH.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A morën përgjigje edhe pyetjet e tjera?

Faleminderit!

Përfaqësuesi i Presidentit ka kërkuar fjalën.

Bledar Dervishaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Në rutinën e praktikës parlamentare kur shqyrtohet dekreti i Presidentit të Republikës ne jemi mësuar që fjalën ta marrim të parët, duke parashtruar një përmbledhje të arsyeve, kjo për të kursyer edhe kohën e komisionit, por relatorja në mënyrë të përmbledhur bëri një përmbledhje të gjetjeve kryesore të konstatimeve dhe vlerësimeve të Presidentit të Republikës.

E vërteta është, nisur nga pyetjet e deputetes së nderuar drejtuar Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, se Presidenti ka adresuar në dy shkresa të veçanta, kërkesë për informacion Kuvendit, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Transportit dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar, si autoriteti kontraktor, duke sugjeruar, për shkak të afatit të shkurtër 20-ditor të shqyrtimit të ligjit, që ky informacion të jepej brenda datës 5 gusht. Por nuk është

kthyer përgjigje brenda afatit të shqyrtimit as nga Autoriteti Rrugor, as nga Ministria e Transportit dhe as nga Ministria e Financave.

Pyetjet kanë qenë koncize dhe të drejtpërdrejta për të gjitha palët. Nëse më lejoni, unë mund t'i ripërsëris në mënyrë shumë të shkurtër, sepse 4 pyetje janë.

Referuar kërkesave dhe procedurave të parashikuara në VKM-në nr.634 të vitit 2014, nga Ministria e Infrastrukturës dhe nga ARSH-ja kërkohen këto të dhëna:

Sa është vlera fillestare e propozimeve të pakërkuara të paraqitura pranë autoritetit kontraktor për segmentin rrugor Orikum – Llogara, nuk po e citoj segmentin rrugor Milot – Balldren, sepse është procedurë më vete?

Autoriteti kontraktor a ka realizuar një studim krahasimor nga ku ka rezultuar ekonomikisht më i përshtatshëm procedura PPP apo prokurimi publik. Nëse po, sa është vlera e këtyre projekteve në prokurim publik në raport me vlerën finale të kontratave, që janë nënshkruar midis palëve? A është dërguar për miratim pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë projekti i segmentit rrugor Orikum-Llogara, dhe a është dhënë miratimi nga kjo ministri? Nëse po, në çfarë vlere, në vlerë fillestare, atë të ofertuar apo është negociuar?

Pra, ne kemi kërkuar të dimë sa është kostoja e këtij projekti: 50 milionë e 147 mijë e 416 euro, 67 milionë e 359 mijë e 926 euro, apo 70 milionë e 119 mijë e 755 euro? A ka një studim fizibiliteti për segmentin rrugor Orikum-Llogara të hartuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar apo Ministria e Transportit? Nëse po, sa është kostoja e parashikuar e këtij projekti? Cila është baza ligjore ku jeni mbështetur për negocimin e ofertës së paraqitur nga shoqëria fituese e kësaj procedure, nisur nga fakti që në dokumentet e tenderit kjo është e ndaluar? Kjo është edhe në VKM-në që rregullon procesin. Sipas vlerësimit të autoritetit kontraktor, Ministrisë së Transportit dhe Autoritetit Rrugor, a cenohet projekti prej uljes së çmimit të ofertuar nga shoqëria fituese?

Këto janë pyetjet kryesore që i kemi drejtuar Ministrisë së Transportit dhe nuk morëm përgjigje. Është një proces apo një procedurë, një rutinë e Ministrisë së Transportit në mënyrë të përsëritur kundrejt institucionit të Presidentit të Republikës, edhe në rastin e Unazës së Madhe. Institucionit të kreut të shtetit nuk është kthyer përgjigje dhe për këtë kërkoj tërheqjen e vëmendjes ndaj Kuvendit të Shqipërisë.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Besoj se i keni dërguar pyetjet në ministri dhe jo në Kuvend, apo jo?

Bledar Dervishaj – E vërteta është që shkresat i janë drejtuar Kuvendit dhe Ministrisë, por pyetjet janë adresuar ministrive përkatëse. Kuvendi, për të qenë të qartë, ka

kthyer përgjigje të nesërmen e dërgimit të kësaj shkrese, me rigorozitet, dhe nga shqyrtimi i praktikës parlamentare na rezultonin të mos ishin aktet, për të cilat ne u adresuam.

Arben Ahmetaj – Për korrektesë, pyetjet ia keni dërguar Ministrisë së Infrastrukturës?

Bledar Dervishaj– Po.

Kuvendit i kemi kërkuar praktikën parlamentare të shqyrtimit të këtij ligji, e cila na është vënë në dispozicion.

Arben Ahmetaj – E qartë.

Kërkoj ndjesë për procedurën!

Duhet të kishit folur në momentin e parë, por mendova se do të kërkonit fjalën.

Zonja Blerina, ju kishit diçka për të shtuar?

Blerina Gjylameti – Që në krye të herës, edhe në relacionin e përmbledhur, unë kërkoja të kishim disa informacione në dispozicion nga ministria përkatëse, që e ka propozuar këtë projektligj, për të qenë më shumë shterues në argumentet tona në rrëzimin e dekretit të Presidentit, që kishte të bënte ekszaktësisht me pjesën e informacionit për aktin e miratimit të kësaj kontrate në periudhën përkatëse për Ministrinë e Financave, edhe pse është një projekt, i parashikuar në projektbuxhetin afatmesëm 2019-2021, i propozuar nga Ministria e Financave dhe i miratuar nga Këshilli i Ministrave, dhe më pas edhe nga parlamenti. Gjithashtu, edhe pjesa që ka të bëjë me të gjithë argumentimin për ndryshimin e vlerës së projektit, nga faza e parë që kishte të bënte me koston e projektit, te pjesa me ofertën fillestare të shoqërisë dhe, së dyti, edhe te pjesa e ndryshimit të kuadrit ligjor. Këto ishin në mënyrë të përmbledhur informacionet që nevojiten për të pasur argumente më shteruese në rrëzimin e dekretit të Presidentit.

Gjithashtu, kërkoja të rendisni të gjitha ndryshimet që ka pësuar projekti, që nga përmirësimi në pjesën e gjatësisë, në cilësinë e rrugëve, në veprat e artit apo edhe faktorë të tjerë, të cilët mund të kenë ndikuar në ndryshim.

Gjithashtu, mendoj se duhet theksuar fakti që në argumentimin tonë, ndryshe nga ajo çfarë u përmend më parë nga kolegët, ky projekt ndihmon dhe ndikon në ndryshimet rrënjësore të infrastrukturës rrugore dhe të kolektivitetit jo vetëm brenda Shqipërisë, por edhe ...

Arben Ahmetaj – Më falni!

Ju lutem, ju kameramanë, që bëni bisedë, kjo është mbledhje komisioni! Të mos e përsëris edhe një herë tjetër, sepse i keni bërë zakon bisedat tuaja, ndërkohë që deputetë dhe përfaqësuesit e institucioneve janë duke folur!

Vazhdoni, zonja Blerina!

Blerina Gjylameti – Vlen për t'u përmendur dhe për t'u përsëritur vazhdimisht, që ky është një projekt, i cili do të ndikojë në përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe të konektivitetit, si parakushte për zhvillimin e një prej sektorëve strategjik të ekonomisë shqiptare, si turizmi.

Të gjithë e dimë, duke qenë se jemi edhe në Komisionin e Ekonomisë, që investimet që nxisin rritjen ekonomike sjellin qoftë rritje të punësimit në ato zona, qoftë përmirësime të kushteve, po ashtu, edhe të ardhura që vijnë nga sektori bazë i ekonomisë shqiptare, nga sektori strategjik, sikundër është turizmi.

Prandaj, në përgjigje edhe të shqetësimeve që ngritën kolegët, ne duhet të përmirësojmë kushtet në të cilat zbatohen këto kontrata koncensionare. Kjo ka qenë edhe pjesë e projektligjit që është miratuar dhe ne e rrëzuam përsëri dekretin.

Po ashtu, vlen për t'u theksuar fakti që deri më sot të gjitha kontratat koncensionare të partneritetit publik-privat nuk kanë cenuar stabilitetin makroekonomik të vendit dhe borxhin publik, por janë parakushte të investimeve strategjike, që ndikojnë në përmirësimin dhe nxitjen e rritjes ekonomike, duke investuar në sektorët strategjikë të ekonomisë shqiptare, sikundër turizmi, bujqësia e të tjerë.

Ndaj, do t'u bëja thirrje të gjithë kolegëve të rendisin faktorët apo argumentet pro dhe kundër, por të mos fshehin të vërtetën, që ekonomia shqiptare sot është shumë herë më mirë se para disa vitesh.

Të gjithë treguesit makroekonomikë dhe të borxhit kanë treguar që kemi qenë në drejtimin e duhur në këta 6 vjet, qoftë në pjesën e investimeve, qoftë në të gjitha reformat strukturore, të cilat kanë bërë të mundur të kemi një situatë më të mirë.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

(Mungesë regjistrimi.)

...që përsëriti zonja Gjylameti. I lutem ministrisë të japë përgjigje për të gjitha shkresat që dërgon Kuvendi. Ndërkohë, ju tërheq vëmendjen (sigurisht, kjo nuk është përgjegjësi e Kuvendit) edhe për moskthimin e përgjigjeve për pyetjet që ka bërë Presidenca.

Më fal, por përfaqësuesi i Presidencës tha se ju nuk keni kthyer përgjigje!

Po, urdhëro!

Alda Klosi – Dua të sqaroj diçka: Ministria e Financave i është përgjigjur Presidencës me anë të shkresës, ku u ka dhënë përgjigje pyetjeve që Presidenca ka ngritur për moskthimin e përgjigjes për këtë projekt.

Ministria e Financave e ka miratuar projektin në parim, në bazë të dispozitave të legjislacionit të fushës dhe është shprehur për këtë projekt në parim të të gjithë studimit të fizibilitetit, të draftkontratës apo dhe të ofertës së negociuar.

Arben Ahmetaj – Ia keni vënë në dispozicion...?

Alda Klosi – Po, me shkresë zyrtare, duke përcjellë edhe shkresën ku ka argumentuar edhe qëndrimin.

Bledar Dervishaj – Është e nevojshme të sqarohet, sepse keqkuptohet opinioni publik, që Presidenti i ka kërkuar Ministrisë së Financave (më korrigjo, kolege), me shkresën nr.2670, datë 31.07.2019... Besoj se kjo është administruar nga ju në të njëjtën datë, sepse është dorëzuar edhe me postier. Ministria e Financave, që të jemi të saktë me njëri-tjetrin, ka kthyer përgjigje me shkresën nr.14594/1, datë 07.08.2019, dërguar nëpërmjet shërbimit postar (se e mora edhe zarfin, sepse e prisja këtë) në datën 8, administruar në datën 9, për hir të vërtetës, nga shërbimi i Gardës, jo nga ne.

Arben Ahmetaj – Në datën 9 gusht?

Bledar Dervishaj – Një ditë mbas dekretit.

Unë e thashë shumë qartë, deri në ditën e shqyrtimit të kësaj çështjeje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të mos harrojmë se ne kemi cituar në shkresën tonë, në kërkesën tonë, që mundësisht deri në datën 5, për arsye të shqyrtimit...

Për më tepër, po t'i hyj edhe shqyrtimit të themelit të saj, ju e thatë bukur, e keni miratuar në parim, keni lënë edhe nja 20 detyra këtu për autoritetin kontraktor, që nuk dihet nëse janë plotësuar apo jo dhe nuk kuptohet në çfarë vlere është miratuar kjo kontratë koncensionar, për të qenë të saktë.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Në rastin konkret, Ministria e Financave nuk është autoritet kontraktor.

Bledar Dervishaj – Jo, Ministria e Transportit.

Arben Ahmetaj – Po, pra. Ministria e Financave kujdeset për balancën fiskale, është pjesë e autoritetit të vet, por...

Bledar Dervishaj – Jemi të qartë, por përgjigjja ishte për...

Arben Ahmetaj - ...por përgjigjja nuk ka arritur në kohën e duhur.

Bledar Dervishaj – Ka mbërritur një ditë me vonesë.

Arben Ahmetaj – Jemi të qartë.

Kalojmë në votimin e dekretit të Presidentit.

Kush është pro dekretit të Presidentit nr.11254, datë 08.08.2019, “Për kthimin e ligjit nr. 51/2019 “Për miratimin e kontratës së koncesionit/PPP ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si autoriteti kontraktor, dhe “Gjikuria” sh.p.k., si koncesionari, dhe shoqërisë koncensionare “Ruga Orikum-Llogora”, sh.p.k., për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugës “Porti i jahteve - By-Pass Orikum - Dukat (ura e Shën Elizës)””? 4 vota janë pro.

Kush është kundër?

Atëherë, dekreti rrezohet në Komisionin e Ekonomisë dhe i referohet seancës për gjykim, në bazë të procedurës parlamentare.

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 03.09.2019, ora 10.30

Drejton mbledhjen:

Arben AHMETAJ – Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11255, datë 08.08.2019, “Për kthimin e ligjit nr. 52/2019 “Për miratimin e kontratës së koncesionit/PPP ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si autoriteti kontraktor, shoqërisë “ANK”, sh.p.k., si koncesionari, dhe shoqërisë “Bardh konstruksion”, sh.p.k., si shoqëria koncesionare, për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor Milot – Balldren””

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Evis Kushi, Senida Mesi, Blerina Gjylameti, Krenar Ryci, Ervin Bushati, Reme Lala, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Suzana Topi, Korab Lita, Ardit Konomi, Sadi Vorpsi dhe Dritan Bici, Xhevit Bushaj, Antoneta Dhima, Artemis Dralo (Malo)

Mungojnë:

Anastas Angjeli, Vullnet Sinaj, Arben Elezi

Të ftuar:

Anila Denaj – Ministre e Financave dhe Ekonomisë

Elton Haxhi- Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Rovena Beqiraj – përfaqësuese e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Alda Klosi - përfaqësuese e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Endri Ducka - përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Ergys Misha - përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Artan Shkreli – Zëvendësministër i Infrastrukturës

Teuta Balili - Drejtore në Ministrinë e Infrastrukturës

Enea Karakaçi – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës

Bledar Dervishaj - Këshilltar Ligjor i Presidentit

Krisilda Fana - Drejore e Drejtorise Juridike në Presidencë

Arben Ahmetaj - Kalojmë te shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11255, datë 8.08.2019, “Për kthimin e ligjit nr. 52/2019 “Për miratimin e kontratës së koncesionit/PPP ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si autoriteti kontraktor, shoqërisë “ANK”, sh.p.k., si koncesionari, dhe shoqërisë “Bardh konstruksion”, sh.p.k., si shoqëria koncensionare, për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor Milot-Balldren””.

Ftoj përfaqësuesin e Presidencës të mbajë qëndrimin e vet për dekretin e Presidentit. Më pas do të vazhdojmë me relatimin.

Bledar Dervishaj – Faleminderit, kryetar!

Do të mundohem të flas shkurtimisht, sepse arsyetimi është i gjatë (17 faqe). Unë nuk do ta lexoj të gjithë arsyetimin, edhe për ekonominë e kohës suaj.

Argumentet janë pothuajse të njëjta me dekretin e segmentit rrugor Orikum-Dukat.

Kuvendi i Shqipërisë, në seancën plenare të datës 18 korrik, ndër të tjera ka miratuar edhe ligjin nr. 52/2019, për miratimin e kontratës koncensionare /PPP ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe shoqërisë “ANK”, për segmentin rrugor Milot-Balldren.

Kjo kontratë koncensionare, së bashku me ligjin e miratuar, i është dërguar institucionit të Presidentit të Republikës për miratim dhe shpallje të ligjit.

Në përfundim të shqyrtimit, Presidenti konstatoi se projektimi, ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugës Milot-Balldren, sipas kontratës dhe objektit të saj, është paraqitur në formën e një propozimi të pakërkuar për zbatimin e një projekti PPP nga shoqëria “ANK”, si koncensionare dhe shoqëria “*Bardh konstruksion*”, si shoqëri koncensionare.

Në relacionin e qeverisë, por edhe në raportet e Kuvendit, përshkruhet se nëpërmjet kësaj kontrate koncensionare do të ndërtohet një rrugë me gjatësi 17 kilometra e 263 metra, e cila shtrihet përgjatë aksit të rrugës Milot deri në qytetin e Lezhës dhe devijohet si rrugë plotësisht e re nga nyja e qytetit të Lezhës, deri në Balldren, ku më pas lidhet me rrugën ekzistuese në drejtim të Shkodrës.

Nga shqyrtimi u vërejtën këto mangësi: ligji nr.52/2019 dhe kontrata koncensionare bashkëlidhur tij, janë propozuar, hartuar, nënshkruar, dhe miratuar në kundërshtim me parimin e shtetit të së drejtës. Ky ligj miraton një kontratë koncensionare, ku vullneti i

qeverisë shqiptare në këtë proces është formuar në kundërshtim të hapur me interesin publik dhe në shkelje të parimit të konkurrencës dhe të barazisë para ligjit.

Kontrata e lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik është formalizuar përgjatë një procesi aspak transparent ndaj publikut dhe pa një bazë ligjore për negocimin e çmimit të saj.

Mungesa e një vlerësimi të qartë ekonomik krijon rrezik për cenimin e financave të shtetit.

Nuk rezulton të ketë një studim fizibiliteti të plotë dhe objektiv, të hartuar dhe miratuar nga institucionet shtetërore përgjegjëse, të ngarkuara me ligj për këtë detyrë.

Nuk është dhënë miratimi i këtij projekti nga Ministria e Financave konform kërkesave të aktit që rregullon këtë proces (vendimit të qeverisë).

Kontrata riskon seriozisht buxhetin e shtetit, sepse nuk ka një përlogaritje të saktë të efekteve në ekonominë e vendit.

Qëllimi i miratimit me ligj të kësaj kontrate është vetëm mbulimi i paligjshmërisë së bërë nga autoriteti kontraktor dhe qeveria shqiptare, me qëllim mosevidentimin e përgjegjësisë në këtë proces dhe mbulimin e çdo paligjshmërie nëpërmjet ligjit.

Presidenti, në ushtrim të kompetencave të tij, në zbatim të nenit 85, pika 1 dhe 93 të Kushtetutës dhe në përfundim të shqyrtimit, me dekretin nr. 11255, datë 08.08.2019, ka vendosur kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr.52/2019, me qëllim rishikimin e ligjit dhe të kontratës koncensionare, sipas arsyetimit bashkëlidhur këtij dekreti.

Arsyetimi është shumë i gjatë, por unë bëra një përmbledhje të të gjitha gjetjeve kryesore. Për çdo gjetje ka një arsyetim në dekretin bashkëlidhur.

Për të mos i marrë më shumë kohë komisionit, po e mbyll këtu fjalën time.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Besoj se edhe relatori ka qëndrimin e vet.

Ervin Bushati – Faleminderit, kryetar!

Presidenti ka të njëjtën logjikë si në diskutimet e mëparshme. Ne mbajmë të njëjtin qëndrim logjik, sepse në të vërtetë qëndrimi i Presidentit, në thelb, është politik. Të gjitha diskutimet dhe pyetjet që janë ringritur, mendoj se morën përgjigje edhe kur i parashtroui opozita në komision apo edhe në seancë plenare, kur ne i miratuam të dyja projektligjet. Pyetjet janë teknike si për sa u përket parametrave apo logjikës financiare, ashtu edhe inxhinerike. Kështu që nuk besoj se është në thelb puna e këtij komisioni. Qëndrimi politik i Presidencës në këtë rast për të paragjykuar apo për të hyrë në diskutime, që janë në vetvete prerogativa qeverisëse për sa u përket buxhetimit apo investimeve afatgjata, nuk janë

prerogativa të Presidencës. Gjithashtu, këto investime afatgjata duhet të bëhen nga një qeveri, njësoj sikur e ka prerogativë të miratojë buxhetin, të ketë bono thesari. Pra, në të njëjtën kohë janë investime afatgjata, për t'u dhënë edhe një përgjigje pretendimeve jo argumenteve ekonomike të opozitës për sa u përket këtyre investimeve.

Gjithashtu, në thelb qëndrimi i zonjës Gjylameti është baza e asaj që mund të themi dhe në këtë rast është pikërisht argumenti pse ne duhet t'i qëndrojmë vendimmarrjes sonë të parë dhe të rrëzojmë dekretin e Presidentit.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – A ka ndonjë koment ose qëndrim ministria, përtej këtyre që tha relatori? Nuk ka.

A ka ndonjë diskutim?

Do t'ju lutesha që të jeni sa më konciz, në referencë të kohës.

Artur Roshi – Sigurisht, këto i ngjajnë njëra-tjetrës dhe problemet janë të njëjta, prandaj edhe argumentet që vijnë nga Presidenti janë të njëjta. Besoj se këtu pajtohemi të gjithë, por sërish duhet të thellohem tek arsyetimi teknik e ekonomik i këtyre PPP-ve. Për ta thjeshtuar, dua të them se askush nga ne nuk do të guxonte të merrte kredi, të cilën nuk e përballon dot. Domethënë, qeveria po merr një kredi edhe për brezat që vijnë, por nuk e di a do të përballohet dot nga ekonomia e ardhme e vendit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Zoti Bushati, mos i ndërhyri deputetit! Kur unë pyes nëse ka pyetje ose komente, ka procedurë parlamentare. Ndryshe unë, me të drejtën e kryetarit, mund t'i ndërhyj kujtdo dhe të mos e lë fare të flasë

Artur Roshi – Nuk është përgjigje kjo, pra që kështu bën çdo qeveri. Pse duhet bërë? A ka argument për këtë? Nuk ka.

Në fillim, kur ju erdhët në pushtet, në vitin 2013 thatë se e gjetët borxhin e madh, për shembull, te rrugët. Sot po krijoni një borxh shumë më të madh, por që e shtrini në vite, ku është ndryshimi këtu midis asaj që ju kritikoni dhe midis kësaj që ju bëni sot?! Këto janë të thjeshta. Sigurisht, qeveria mund të bëjë çfarë të dojë, mund të kthehet në totalitare dhe mund t'ua marrë pronat njerëzve. Ne e dimë këtë, por flasim për një logjikë demokratike dhe për investime që do t'u shërbejnë njerëzve. Kjo është ajo për të cilën unë këmbëngul. Këto janë gjëra të përsëritura dhe nuk ia vlen të zgjatesh, por mund të bëj një pyetje retorike: pse nuk bëtë një rrugë tjetër, për shembull, Milot-Durrës, që do të ishte një aks, i cili vërtet mund të kishte një lloj impakti në ekonominë e vendit, por bëtë, gjasme në shërbim të turizmit, aksin Milot-Balldren?! Zero është efekti që do të japë ky lloj investimi, por paratë që merren

janë të shumta. Pra, jep efekt negativ tek e ardhmja jonë dhe tek të ardhurat tona. Neve na i shtoni në këtë mënyrë shpenzimet fikse, që duhet të paguajmë në të ardhmen dhe do të bllokohet ekonomia në vitet që vijnë. Sigurisht, në mentalitet dhe në filozofi nuk presim ndonjë gjë më shumë se kjo, por, njerëzisht, mund t'ju ftoj edhe një herë që t'i thërrasim arsyet dhe ta votojmë pro dekretin e Presidentit.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Një sqarim për deputetin Roshi: praktikisht, këto janë procedura qeveritare (dua të sqaroj borxhin) të bazuara në të njëjtat parime. Pra, ligjet e partneritetit publik privat dhe koncesionet kanë parimet bazë të ligjeve standardeve ndërkombëtare të demokracive të konsoliduara dhe të strukturave financiare shtetërore të konsoliduara. Pra, këtu nuk kemi asnjë shpikje. E njëjta formulë përdoret dhe unë solla shumë shembuj herën e kaluar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju thoni do të paguhet nga taksat. Çdo gjë që paguhet nga buxheti i shtetit, paguhet nga taksat. Nuk ka nevojë të themi që një dhe një bëjnë dy, sepse më pas i bie që të jemi si dikush që fillon dhe bën nga këto batuta. Ajo që ndryshon në rastin konkret është që, me mundësitë aktuale të buxhetit të shtetit për të ofruar një rrugë brenda 3 vjetësh, është e pamundur, atëherë qeveria ka të drejtë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk po merr kredi qeveria. Në mos gabohem, ju jeni me profesion inxhinier dhe e dini shumë mirë këtë gjë, pra e dini që kjo nuk është kredi. Ky është detyrim afatgjatë. Në bazë të procedurës dhe, kur i referoheni procedurës, procedura është bërë me procedurë që shkon në APP, do të thotë se në finale edhe PPP-ja, edhe koncesioni janë procedurë e një tenderimi publik. Diferenca është në procedurën e ftesës. Në rastin konkret ligji ka lejuar ftesën, më pas i ka dhënë detyrimin, përgjegjësinë autoritetit kontraktual që të gjykojë leverdishmërinë ekonomike, për kostot, më pas futet Ministria e Financave jo për të gjykuar këto kosto, por për të gjykuar për ngarkesën fiskale që nuk ka kaluar, përkundrazi, është shumë poshtë nga 5% e të ardhurave tatimore totale të vitit të kaluar. Pra, pse e kemi futur 5%-shin?! Që mos ta bëjmë debatin nëse e mban apo nuk e mban buxheti. Do ta paguajnë taksat tona. Çdo gjë që investohet nga buxheti apo që shpenzohet nga buxheti, patjetër që e paguajnë taksat tona. Kur e themi këtë, sa bëhemi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, Kushtetuta, ligjet kanë vendosur autoritet përgjegjës edhe për investimet publike, edhe për PPP-të apo koncesionet. Në qoftë se ju i referoheni mandatis, unë po ju përmend

Rrugën e Kombit, që nuk ka mbaruar ende, ndërkohë që mandati i asaj qeverie, që e avancoi si investim, ka mbaruar para 6 vjetësh. Pra, nuk është kjo logjika, sepse ato nuk janë asetet e një qeverie, por të gjithë vendit dhe mbeten. Të bësh pyetje retorike (nuk e kam për ju, por e kam në tërës) a duhej kjo rrugë apo nuk duhej kjo rrugë... Diskutimi në komision mund të vazhdojë sa të dojë në këtë frymë, por prandaj kemi caktuar autoritete përgjegjëse. Autoritetet përgjegjës janë Ministria e Infrastrukturës dhe qeveria. Autoriteti fiskal që përgjigjet për borxhin dhe deficitin, është Ministria e Financave. Pyetjet do t'ua bëjmë atyre institucioneve dhe ato institucione kanë përgjegjësinë ligjore, kushtetuese dhe, po deshe, morale dhe politike, që, kur vijnë, të flasin në Kuvend: "Po, ne e kemi bërë studimin; ne mendojmë që çmimet referente të manualit janë të respektuara". Këto janë fjalë ligjore me përgjegjshmëri dhe përgjegjësi këtu. Në qoftë ministria nuk do të thoshte të vërtetën, ka përgjegjësi ministria. Aty ka dokumente. Patjetër, kjo është e drejta jonë dhe është detyrimi i institucioneve të sjellin informacion të detajuar kur deputetët duan të futen në detaje, sepse në finale është ratifikim kontrate. Deputetët nuk hyjnë dot në detajet e autoritetit kontraktor, edhe po të duan, pavarësisht se dikush është financier, dikush është ekonomist, dikush është jurist dhe nuk ka rëndësi fare kjo gjë. Nuk hyn dot, sepse do staf të kualifikuar dhe ministri ka logjikën e filtrimit. E filtron komisioni, e filtron ARRSH-ja dhe ministri nuk është specialist për të hyrë në detajet teknike të rrugës. Prandaj ka përgjegjësi me radhë. Megjithatë, është detyrimi i ministrive të kthejnë përgjigje kur Presidenti dhe Kuvendi kërkojnë informacion, dhe unë do të vendos një rregull në komision që, kur ka një kërkesë, duhet të vendosim edhe një datë për kthimin e përgjigjes. Nëse brenda asaj date ministritë nuk kthejnë përgjigje, bëhet parashtrimi pranë qeverisë dhe, praktikisht, ministria penalizohet në bazë të Rregullores së Kuvendit. Pastaj se çfarë bën Kryeministri me ministrinë është punë e tij.

Faleminderit!

Urdhëroni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të kemi shumë seanca të tjera dhe unë jam i bindur që ti me diligjencën tënde do të flasësh në të gjitha seancat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti e di që unë jam punonjës i vjetër i shtetit që nga viti '92.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

Edlira Hyseni – Unë do të përpiqem të jem më sintetike, meqenëse qëndron e njëjta logjikë dhe i njëjti argumentim dhe bëhet fjalë për të njëjtat çështje.

Së pari, unë nuk jam dakord me zotin Bushati, i cili gjykon se nuk është detyrë e komisionit të hyjë në detaje financiare dhe inxhinierike, pasi, nëse ne nuk shprehemi për treguesit financiarë, atëherë për çfarë kalon në Kuvend?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord. Nuk ju kuptova.

Për ta përmbledhur sa më shkurt, unë dua të bëj pyetjet dhe dua përgjigje, sepse pyetjet nuk janë retorike.

Së pari, lidhur me rastin e PPP-së Milot-Balldren, a ka dhënë Ministria e Financave me shkrim miratimin për projektin dhe, nëse po, a e ka dhënë në parim apo në vlerë? A ka një shkresë zyrtare që Ministria e Financave miraton PPP-në Milot-Balldren?

Së dyti, duke e parë sot, pasi keni pasur kohë t'i rishikoni, a jeni të bindur që vlera e këtij projekti 17 kilometra për aksin Milot-Balldren ka një kosto të pranueshme logjike, ekonomike dhe të leverdishme për shqiptarët, në vlerën 213 milionë euro? A i keni më të detajuara sot informacionet, domethënë, a e dini sa do të bëjnë ato urat e famshme, të cilat në total ishin 30 milionë, por që nuk e dinin sa bën një urë? A jeni ende të bindur se shoqëria koncesionare A.N.K sh.p.k i disponon mjetet dhe është shoqëria e duhur për të bërë këtë vepër të madhe publike?

Së fundi, unë jam ende në pritje të një përgjigjeje, që më thatë ju personalisht se do të ma kthenit brenda 24 orëve, lidhur me një gabim, apo lapsus, të llogaritjeve në preventiv, për të cilën unë nuk mora përgjigje, por besoj se asnjë nga kolegët nuk mori. Prandaj, për korrektësi, meqenëse e morët përsipër që do të jepnit një përgjigje, dua një përgjigje formale nëse ka qenë një lapsus.

Këto ishin pyetjet e mia. Gjithsesi, unë jam kundër këtij projekti.

Faleminderit!

Artan Shkreli – Është e vërtetë që ne thamë se do ta jepnim përgjigjen brenda 24 orëve, por kërkesa nga ju nuk na arriti kurrë. Nuk mjafton një kërkesë verbale nga këtu për t'i dhënë përgjigje zyrtare nga ana e ministrisë. Për të gjitha pyetjet që mund të ketë komisioni me natyrë teknike, juridike ose edhe në parim, duhet t'i shkruani dy rreshta ministrisë dhe ju vjen përgjigja.

Për sa i përket çështjes që u ngrit pak më parë, që supervizori zgjidhet nga koncesionari, nuk është aspak e vërtetë, sepse supervizorët nuk zgjidhen nga koncesionari, por zgjidhen përmes një procesi tenderimi nga ministria...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj- Zoti Roshi, ju lutem!

Artan Shkreli – Nuk paguhet nga koncesionari, por nga buxheti i shtetit. Ju flisni me siguri për gjëra të pavërteta. Më vjen keq.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është ashtu.

Së pari, zgjidhet me proces tenderimi, konkurrimi dhe komisioni është nga ministria. Pra, as koncesionari nuk bën pjesë në komision.

Së dyti, paguhet nga buxheti i shtetit, që do të thotë se supervizori mbron interesat e entit kontraktor të shtetit.

Arben Ahmetaj- Më fal, zoti Zëvendësministër, por dua t'ju sqaroj se opozita e hedh politikisht këtë, sepse ata e dinë mirë se supervizori ka një proces komplet tjetër zgjedhjeje, por e thonë politikisht meqenëse...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Teknikisht supervizori ka procedurë përzgjedhjeje krejt tjetër, por fondet mund të jenë nga buxheti i shtetit ose autoriteti kontraktor e detyron koncesionarin, brenda kostos së vet, të parashikojë fond për supervizorin që nuk e zgjedh vet. Pra, autoriteti kontraktor thjesht vendos nëse do ta mbaj koston vetë në buxhet apo do t'ia kalojë..., por procedura e përzgjedhjes është me procedurë tenderi publik.

Zoti Zëvendësministër, kam një vërejtje për ju, jo si individ, por si zëvendësministër. Kur pyetja bëhet në komision, pavarësisht jeni ose jo në gjendje t'i përgjigjeni, sepse është normale dhe e natyrshme që nuk mund t'i përgjigjeni, pasi mund të jetë një detaj teknik që rrallë kush mund ta dijë dhe përfaqësuesi politik nuk e di, nuk keni nevojë për dy rreshta letër, sepse keni marrë qëndrim zyrtar, ku keni thënë që do të ktheni përgjigje për 24 orë. Ju ishit të detyruar të ktheni përgjigje në atë moment, por komisioni ju bëri një tolerim, sepse nuk e dinit përgjigjen dhe automatikisht nuk kishit nevojë për dy gishta letër. Ju duhet ta kthenit përgjigjen brenda 24 orësh, siç kishit konfirmuar. Mos e bëni disa herë këtë gjë, sepse procedura parlamentare është shumë rigoroze dhe për projekte qoftë juridike, qoftë juridiko-financiare, ligjesh, draftligjesh, draftkontartash apo kontratash, janë elemente të rëndësishme që ju ndihmojnë ju dhe ne në favor të transparencës ndaj publikut. Secili ka të drejtën e vet të mbajë qëndrime, Presidenti bën të vetën, Kuvendi bën të vetën, Komisioni bën të vetën, ministria bën të vetën, qeveria bën të vetën, deputetët bëjnë të vetën, por që në finale, kur ka pyetje nga autoritetet, jeni të detyruar të ktheni përgjigje, sidomos kur merrni qëndrim zyrtar dhe thoni se për 24 orë do të jepni përgjigje. Nëse ju thoni se për 24 orë do të

keni një përgjigje, atëherë ky është qëndrim zyrtar përpara komisionit. Kështu që besoj se debati për dy rreshta pyetje nuk do të përsëritet më dhe përgjigjet do të jenë në kohë për komisionin, për deputetët, për Presidentin apo për Kuvendin në tërësi.

A ka ndonjë qëndrim tjetër?

Bledar Dervishaj – Kam diçka të vogël, jo për të debatuar me asnjë prej deputetëve apo relatorin, lidhur me qëndrimin dhe rolin e kreut të shtetit në këtë proces. Dua të them se Kushtetuta e ka ndarë qartë rolin e kreut të shtetit në të gjithë këtë proces që zhvillohet në Kuvend dhe në një republikë parlamentare në tërësi janë të ndërtuara edhe mekanizmat e ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Më falni, sepse mund të duket si leksion, por që duhet thënë! Presidenti ka rol neutral dhe të balancuar për ruajtjen e ekuilibrit brenda funksionimit në një shtet demokratik. Këtu ai nuk është as pjesë e ekzekutivit, as e legjislativit dhe as e gjyqësorit, por qëndron mbi këto dhe ushtron kompetenca që diktojnë mënyrën e organizimit të tyre, për shembull, ai emëron një ministër, shqyrton një ligj, siç është rasti konkret. Qeveria në muajin mars të vitit 2019, me ndryshimet që i bëri kuadrit ligjor rregullator në fushën e prokurimeve, zgjodhi që këto kontrata të miratohen me ligj, prandaj vijmë në Kuvend. Ndoshta Presidenti nuk do të kishte mundësi të ushtronte kontrollin presidencial në këtë formë, ai mund ta kishte në një formë tjetër, duke kërkuar informacion, por, kur vjen për dekretim dhe shpallje një ligj, i cili ka vetëm një faqe dhe një nen, por që bashkëlidhur tij ka një kontratë me 270 faqe, e cila pas miratimit nga Kuvendi kthehet në ligj, atëherë Presidenti i ka të gjitha mundësitë ta kontrollojë, sepse ka ekspertët ekonomikë, juridikë, të mbrojtjes, inxhinierikë e të tjerë. Kështu që roli i kreut të shtetit në këtë proces është kontrollues mbi mënyrën sesi është formuar vullneti i qeverisë që i ka propozuar Kuvendit këtë formë, këtë kontratë koncesionare, në të cilën, sipas vlerësimit tonë, është gjetur në shkelje procedurash. Është Kuvendi që kontrollon apo vlerëson veprimtarinë e Presidentit, dekretin, dhe vendos rrëzimin apo miratimin e tij.

E bëra këtë ndërhyrje, sepse duket sikur Presidenti nuk ka rol në këtë proces.

Arben Ahmetaj – Besoj se u keqkuptuat, sepse deputeti relatues iu referua diçkaje tjetër dhe nuk u diskutua që Presidenti shprehet për ligjet me dekret dhe është në të drejtën e vet kushtetuese.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, pasi as Kuvendi nuk arrin të futet te logjika inxhinierike, gjeologjike dhe financiare në detaje, sepse është autoriteti kontraktor me ligj. Megjithatë nuk është ky debati, sepse Presidenti i Republikës ka shprehur qëndrimin e tij kushtetues, në bazë të Kushtetutës,

me ligjin që aprovoi Kuvendi me dekret dhe ne po vazhdojmë procedurën parlamentare për të shqyrtuar dekretin.

Kalojmë te votimi i dekretit. Kush është pro shqyrtimit të dekretit të Presidentit nr. 11255, datë. 08.08.2019, “Për kthimin e ligjit nr. 52/2019 “Për miratimin e kontratës së koncesionit/PPP ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si autoritet kontraktor, shoqërisë A.N.K sh.p.k, si koncesionari, dhe shoqërisë “Bardh konstruksion” sh.p.k, si shoqëria koncesionare për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor Milot-Balldren”? Kush është kundër?

Atëherë, dekreti i presidentit rrëzohet në Komisionin e Ekonomisë dhe i referohet seancës së Kuvendit për shqyrtim dhe vendimmarrje përfundimtare parlamentare.

Këtu mbyllet rendi i ditës.

Faleminderit për prezencën, për durimin dhe pjesëmarrjen!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti